

Nr. _____ Prot.

Tiranë më __/__/2019

Lënda: **Njoftim**
Mbi njoftimin e zhvillimit të mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të jashtëzakonshme të Aksionarëve të Shoqërisë SiCRED sh.a.

Për: **z.Aleksander PILO**
z.Renis TERSHANA
z.Maltin KORKUTI
znj.Monika MILO
znj.Emi SANTO
z.Egi SANTO
z.Petraq SHOMO
z.Arben TAIPI
z.Artan XHORI
z.Kristino KROMIDHA

Të nderuar aksionarë të shoqërisë SiCRED sh.a.,

Bazuar në Statutin e shoqërisë SiCRED sh.a., si dhe neneve 137, 139 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, (i ndryshuar), depozitohet në vëmendjen tuaj, kërkesën për zhvillimin e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Jashtëzakonshme të Aksionareve të shoqërisë SiCRED sh.a., me rend dite të listuar si vijon:

1. “Mbi miratimin e raportit të auditit të pavarur, pasqyrave financiare vjetore të audituara, si dhe pasqyrave financiare të konsoliduara të shoqërisë SiCRED sh.a., të audituara për vitin e mbyllur më 31-12-2018” sipas tekstit që gjeni bashkëlidhur.
2. “Mbi njohjen e rezultatit të shoqërisë SiCRED sh.a., për vitin e mbyllur me 31-12-2018” sipas tekstit që gjeni bashkëlidhur.
3. Çështje të tjera parashikuar shprehimisht nga ligji.

Sqarojmë se referuar ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 (i ndryshuar), gëzoni:

- të drejtën e përfaqësimit në Asamblenë e Përgjithshme, edhe nëpërmjet një autorizimi përfaqësues, lëshuar për një aksionar tjetër apo person të tretë, vetëm për rendin e ditës të sipërcituar, njoftuar n.p.m., kësaj shkrese; si dhe
- procedura e votimit mund të kryet me votim personal apo me votim me shkresë (*kur jemi para votimit të autorizuar me shkresë, akt i cili duhet të posedohet në origjinal nga përfaqësuesi i autorizuar, ditën e zhvillimit të mbledhjes së njoftuar*), sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Ju lutemi gjeni bashkëlidhur dokumentacionin për të gjitha pikat e rendit të ditës. Mbledhja zhvillohet me datë 31-05-2019, vendi “Banka CREDINS”, Tiranë, ora 17.00..

Me respekt,
Genc KOXHAJ
Drejtor i Përgjithshëm